amf ALBANIA

ePeriodik

PUBLIKIM MUJOR NUMRI 94 | Maj 2016

VËSHTRIM MBI TREGJET

- Tregu i sigurimeve për periudhën janar-prill 2016

ZHVILLIME TË TJERA

- Zhvillohet Mbledhja Vjetore e IOSCO-s mbi sfidat globale të rregullimit të tregjeve të letrave me vlerë
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përfundon zbatimin e projektit “Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare në vend”
- Takime rajonale të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe rajonit të Transkaukazisë
- Seminar trajnues në sigurime nga TIFS
- Seminari ndërsektorial mbi rolin e mbikëqyrjes në grup ose kolegjeve të mbikëqyrjes
- Raportimi i dytë i shqyrtimit të politikës tregtare për Shqipërinë
- Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Shehi përshëndet Konferencën e Dytë Kombëtare për Financën
- Workshop mbi Inspektimet e Kujdesshme në Vend *(Prudencial on-site Inspection)*

EDUKIMI I KONSUMATORIT

IOSCO 2016 – pesë ide për rregullatorët e letrave me vlerë

LAJME NDËRKOMBËTARE

- Greqi
- Kosovë
- Ukrainë
- Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore
- Vendet CIS
- EIOPA organizon stres-testin mbarë-evropian të sigurimeve për vitin 2016

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rruga “Dora Distra”,Nr.10, P.O. Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al

ZHVILLIMET E TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2016

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-prill 2016 kapën vlerën mbi 4.17 miliardë lekë, ose 1.53% më shumë se gjatë periudhës janar-prill 2015. Gjatë periudhës janar-prill 2016, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 300,942 me një ulje prej 3.21% krahasuar me muajin janar 2015.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 10.05% në krahasim me periudhën janar-prill 2015. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me mbi 0.77 miliardë lekë, apo 69.43% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 59.54% të tregut të sigurimeve.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 1.97% gjatë periudhës janar-prill 2016, krahasuar kjo me periudhën janar-prill 2015.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 2.47 miliardë lekë gjatë periudhës janar-prill 2016, duke shënuar një rritje prej 3.61% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 59.54% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

- Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë, të cilat zunë 16.05% të tregut të Jo-Jetës;
- Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme, të cilat së bashku zunë 14.33% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 10.27% krahasuar me periudhën janar-prill të vitit 2015. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori”, e cila përbën 58.63% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-prill 2016

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



ZHVILLIME TË TJERA

Zhvillohet Mbledhja Vjetore e IOSCO-s mbi sfidat globale të rregullimit të tregjeve të letrave me vlerë

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë *(International Organization of Securities Commissions, IOSCO)* zhvilloi më 8-12 maj 2016 në Lima, Peru, Mbledhjen Vjetore mbi sfidat globale të rregullimit të tregjeve të letrave me vlerë. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë, është anëtar me të drejta të plota në këtë organizatë. Ai u përfaqësua në këtë mbledhje nga një delegacion me drejtues të nivelit të lartë.

Mbledhja u fokusua në diskutimet rreth sfidave me të cilat përballen rregullatorët e tregjeve financiare dhe në përgjigjet e mundshme ndaj këtyre sfidave. Bordi i IOSCO-s, Komiteti i Tregjeve në Rritje dhe Zhvillim *(Growth and Emerging Market, GEM),* Komitetet Rajonale dhe Komiteti i Anëtarëve me të Drejta jo të Plota *(Affiliate Members Consultative Committee, AMCC)* diskutuan mbi iniciativat e marra në drejtim të forcimit të tregut të letrave me vlerë dhe rolit të këtij tregu si një burim i qëndrueshëm financimi.

Komiteti i drejtuesve të IOSCO-s aprovoi tekstin e memorandumit të mirëkuptimit shumëpalësh midis vendeve pjesëmarrëse, për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni.

Komiteti i drejtuesve të IOSCO-s aprovoi tekstin e memorandumit të mirëkuptimit shumëpalësh midis vendeve pjesëmarrëse, për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni.

Komiteti i Drejtuesve të IOSCO-s aprovoi tekstin e memorandumit të mirëkuptimit shumëpalësh midis vendeve pjesëmarrëse, për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni, si një mjet i domosdoshëm për rregullatorët anëtarë të IOSCO-s, që pengon shkeljet ndërkufitare dhe mashtrimet në tregun e letrave me vlerë. Gjatë mbledhjes u diskutua

edhe mbi përmirësimin e cilësisë së auditimit, si dhe mbi administrimin e aseteve duke u fokusuar në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.

Lidhur me identifikimin dhe adresimin e rreziqeve të reja u diskutua në mënyrë të veçantë mbi likuiditetin në tregjet e letrave me vlerë të korporatave dhe sigurimin e transparencës në këto tregje. Gjithashtu u diskutua mbi mekanizmat e ndryshëm, që do t'u shërbejnë rregullatorëve të tregjeve të letrave me vlerë në mbledhjen dhe shkëmbimin e informacionit mbi rreziqet kibernetike.

Pjesë e mbledhjes ishte edhe konferenca vjetore, e cila si fokus kryesor pati financimin e SME-ve, edukimin dhe mbrojtjen e investitorit, si dhe shanset dhe sfidat e teknologjive të reja financiare.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përfundon zbatimin e projektit "Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare në vend"

Në datat 09-13 maj 2016 ekspertët e Bankës Botërore Z. John Ashcroft dhe Z. Leendert van Driel zhvilluan vizitën e tyre përmbyllëse mbi projektin "Mbikëqyrja dhe zgjerimi i tregut të pensioneve private vullnetare në vend". Projekti, i cili filloi në vitin 2014, në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të programit të vlerësimit të sektorit financiar *(FSAP)* dhe me mbështetjen e Bankës Botërore, nëpërmjet FIRST Initiative *(Financial Sector Reform and Strengthening Initiative),* pati si synim forcimin dhe zhvillimin e pensioneve private në Shqipëri.

Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore grupi i punës në AMF punoi intensivisht në dy komponentët bazë të projektit, që janë mbikëqyrja me bazë rreziku si dhe zgjerimi i pjesëmarrjes në fondet private vullnetare të pensioneve. Fushat kryesore që u mbuluan në kuadër të këtij projekti ishin: ndërtimi i kuadrit të mbikëqyrjes me bazë rreziku dhe të kapaciteteve mbikëqyrëse; rishikimi i bazës ligjore dhe rregullatore për të mbështetur kuadrin e ri mbikëqyrës; përcaktimi i një plan veprimi strategjik për të mbështetur zgjerimin e tregut të pensioneve private vullnetare.

Në bashkëpunim me ekspertët e Bankës Botërore grupi i punës në AMF punoi intensivisht në dy komponentët bazë të projektit, që janë mbikëqyrja me bazë rreziku si dhe zgjerimi i pjesëmarrjes në fondet private vullnetare të pensioneve.

Në javën e fundit të vizitës përmbyllëse të projektit, u kryen takime me përfaqësues të shoqërive administruese dhe depozitarëve të fondeve të pensionit, si dhe me përfaqësues të kompanive të ndryshme që operojnë në tregun shqiptar.

Pas përfundimit të këtij projekti, Autoriteti do të vazhdojë punën në drejtim të miratimit të manualit të mbikëqyrjes së pensioneve private me bazë rrezikun, implementimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku në tregun e pensioneve private si dhe përmbushjen e planit strategjik të zgjerimit të tregut të pensioneve private vullnetare në vend.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare falënderon Bankën Botërore, ekspertët John Ashcroft, Leendert van Driel dhe William Price, si dhe grupin e punës në AMF për realizimin me sukses të këtij projekti.

Takime rajonale të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe rajonit të Transkaukazisë

Për të zgjeruar më tej bashkëpunimin midis vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe rajonit të Transkaukazisë në datat 16-17 maj u mbajtën në Varshavë të Polonisë dy takime rajonale me specialistë, ekspertë dhe rregullatorë të tregut të sigurimeve nga këto vende. Takimet u organizuan nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Polonisë (KNF).

Në datë 16 maj 2016 u organizua takimi i 11-të i Iniciativës së Evropës Qendrore e Juglindore të Mbikëqyrjes së Sigurimeve *(11-th meeting of the Central –Eastern and South –Eastern European Insurance Supervision Initiative CESEE ISI).* Tematikat e këtij takimi ishin propozuar më parë nga vendet pjesëmarrëse si tematika të cilat ngjallin diskutime dhe interes për të gjithë vendet e rajonit. Kështu, në sesione të veçanta u trajtua:

- Mbikëqyrja e produktit në sigurime dhe qeverisja e prezantuar sipas shembujve të Sllovenisë nga Sergej Simoniti, Drejtor i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sllovenisë;
- Zgjidhja e drejtpërdrejtë e dëmeve, sipas eksperiencës polake e prezantuar nga Pawel Sawicki, Drejtori i Departamentit të Licencimit të Siguracioneve dhe Fondeve të Pensioneve, KNF Polake.

Përfaqësuesit e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare prezantuan dy tematika:

- Zbatimi i vendimeve të mbikëqyrjes dhe sfidat - shqyrtimi i vendimeve të mbikëqyrjes në gjykata, prezantuar nga Znj. Violanda Theodhori, Drejtore e Departamentit të Çështjeve Juridike;
- Menaxhimi i likuiditetit në shoqëritë e sigurimeve, prezantuar nga Z. Artur Ribaj, Drejtor i Departamentit të Mbikëqyrjes.

Temat e trajtuara në takimin CESEE krahas prezantimeve nga secili vend hapën diskutime për eksperiencat dhe sfidat me të cilat përballeshin vendeve të tjera të rajonit.

Në datë 17 maj u organizua takimi rajonal i vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, si dhe të rajonit të Transkaukazisë CEET (*Central, Eastern Europe and Transcoucasia –CEET-region meeting).* Takimi synonte hartimin e planeve të përbashkëta rajonale.

Në fillim të takimit u bë prezantimi i rezultateve të anketës për karakteristikat e tregut të sigurimeve, në mënyrë që të përcaktohej zbatimi i planeve rajonale. Përcaktimi i këtyre planeve duhet të realizohet nëpërmjet identifikimit të prioriteteve të çdo vendi anëtar. Znj. Marta Bartnik –Wojcik nga KNF e Polonisë bëri prezantimin e rezultateve të anketës e cila bazohej në rezultatet dhe treguesit e përfituar nga 19 vende të rajonit. Ajo u ndal në aspekte të veçanta të këtyre rezultateve të paraqitura duke

Znj. Marta Bartnik –Wojcik nga KNF e Polonisë bëri prezantimin e rezultateve të anketës e cila bazohej në rezultatet dhe treguesit e përfituar nga 19 vende të rajonit. Ajo u ndal në aspekte të veçanta të këtyre rezultateve të paraqitura duke kërkuar mendimin e pjesëmarrësve në takim.

kërkuar mendimin e pjesëmarrësve në takim.

Takim vijoi edhe me paraqitjen e ndryshimeve ligjore dhe sfidave rregullatore që ekzistojnë në secilin nga vendet pjesëmarrëse në tregun e sigurimeve.

Në fund të takimit të vendeve të CEET u zhvillua një analizë SWOT për të gjithë rajonin duke evidentuar pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që paraqet i gjithë rajoni. Përfundimet e analizës SWAT do t'ju dërgohen përfaqësuesit të IAIS dhe do të shërbejnë për përgatitjen dhe zbatimit të planeve rajonale dhe programeve të ndryshme, me qëllim zhvillimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e tregut për të gjithë rajonin.

Seminar trajnues në sigurime nga TIFS

Në datat 18-20 maj 2016 u organizua në Varshavë, Poloni sesioni trajnues në fushën e sigurimeve. Organizator i këtij trajnimi ishte Nisma Trajnuese për Mbikëqyrjen Financiare e Polonisë, *(Training Initiative for Financial Supervision, TIFS)* e cila funksionon si një qendër trajnimi për mbikëqyrësit e të gjithë sektorëve të tregut financiar. Nisma TIFS ofron njohuri, përvojë praktike dhe teknikat financiare mbikëqyrëse sipas programeve trajnuese të hartuara për pjesëmarrje aktive, duke ndarë shembujt e praktikave më të mira të mbikëqyrjes dhe standardet e zbatuara. Ato përqendrohen në nevojat e përbashkëta dhe interesat e vendeve të rajonit të Evropës Qendrore e Lindore si edhe BE-së. Në këto trajnime ftohen si lektorë edhe personalitete të njohura të fushës akademike dhe të organizatave ndërkombëtare të fushës së sigurimeve.

Sistemi i Menaxhimit të Rrezikut të Shoqërive (ERM) është projektuar dhe operohet në të gjitha nivelet e shoqërisë së sigurimit për të lejuar identifikimin, vlerësimin, monitorimin, zbutjen dhe raportimin e të gjitha rreziqeve të siguruesit në kohën e duhur.

Tematika e përzgjedhur për trajnimet e këtij viti lidhej me Sistemin e Menaxhimit të Rrezikut (ERM). Mjedisi i biznesit të sigurimit është vazhdimisht në ndryshim dhe i vështirë për t'u parashikuar. Prandaj rreziku, nuk është vetëm një tipar i modelit të biznesit të sigurimit, por ka të bëjë edhe me mjedisin e paqëndrueshëm, në të cilin zhvillohet. Sistemi i Menaxhimit të Rrezikut të Shoqërive (ERM) është projektuar dhe operohet në të gjitha nivelet e shoqërisë së sigurimit për të lejuar identifikimin, vlerësimin, monitorimin, zbutjen dhe raportimin e të gjitha rreziqeve të siguruesit në kohën e duhur. Ai merr në konsideratë mundësinë, ndikimin e mundshëm dhe horizontin kohor të rreziqeve. Tematikat teorike të trajtuara ishin:

- SARP ndaj FSAP, e prezantuar nga Conor Donaldson, Këshilltar i Lartë i IAIS;
- Idetë e kërkesave të menaxhimit të *Solvency II*, në veçanti të menaxhimit të rrezikut, prezantuar nga Karel van Hulle, Profesor i universitetit të Leuven, ideues i *Solvency II* dhe një nga ekspertët më të njohur të zbatimit të *Solvency II*.

Ndërkohë gjatë seancave të tjera dhe në *workshope* u trajtuan edhe:

- Testet *Fit and Proper* nga Pawel Sawicki, KNF Poloni;
- Zbatimi Praktik i ICP ERM në Poloni - evoluimi i praktikave të menaxhimit të rreziqeve - nga Grzegorz Szymanski, KNF Poloni;
- ORSA - zbatimi praktik, rregullat, qëllimet dhe indikatorët matës;
- Eksperienca e Autoritetit Polak të Mbikëqyrjes, KNF lidhur me ORSA, analiza dhe raste studimore - nga Agnieszka Groniowska, KNF Poloni;
- *Stres Testing* - pse duhet të evoluojë në mënyrë që të jetë një instrument i mirë për menaxhimin e rreziqeve – nga Grzegorz Szymanski, KNF Poloni.

Një element i rëndësishëm ishte paraqitja nga ana praktike e zbatimit të Sistemit të Menaxhimit të Rrezikut në kompaninë Warta. Gjithashtu u bë edhe prezantimi i menaxhimit të rrezikut dhe procesit ORSA, sipas mësimeve të nxjerra, shembujve praktikë dhe sfidat e së ardhmes nga eksperienca në këtë fushë e firmës Ernest & Young.

Seminari ndërsektorial mbi rolin e mbikëqyrjes në grup ose kolegjeve të mbikëqyrjes

Fokusi i përshkrimit të institucioneve lidhej me kolegjet e mbikëqyrjes dhe inspektimet në grup, si dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente të vendeve të ndryshme për qëllimin e përbashkët të mbikëqyrjes në fushën bankare, të sigurimeve dhe konglomeratave financiare.

Në datat 12-13 maj 2016, në Berlin, Gjermani u zhvillua seminari ndërsektorial mbi rolin e mbikëqyrjes në grup ose kolegjeve të mbikëqyrjes. Ky seminar u organizua nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA). Pjesëmarrësit në seminar ishin specialistë dhe ekspertë kryesisht nga bankat qendrore dhe autoritetet e mbikëqyrjes financiare të vendeve të Ballkanit, si edhe të Bashkimin Evropian si Anglia, Belgjika, Bosnje-Hercegovina, Bullgaria, Danimarka, Finlanda, Franca, Hungaria, Gjermania, Italia, Maqedonia (FYROM), Norvegjia, Polonia, Serbia, Sllovakia, Shqipëria.

Prezantues dhe lektorë në seminar ishin ekspertë nga autoritete mbikëqyrëse si Autoriteti Federal i Mbikëqyrjes Financiare të Gjermanisë (BaFin), Autoriteti Bankar Evropian (EBA), Autoriteti i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA), Banka Qendrore Evropiane (ECB), Autoriteti i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), etj.

Gjatë ditëve të seminarit u diskutua mbi rolin e institucioneve të ndryshëm të Bashkimit Evropian si: Autoriteti Bankar Evropian (EBA), Autoriteti i Letrave me Vlerë dhe Tregjeve (ESMA), Autoriteti i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA). Fokusi i përshkrimit të institucioneve lidhej me kolegjet e mbikëqyrjes dhe inspektimet në grup, si dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente të vendeve të ndryshme për qëllimin e përbashkët të mbikëqyrjes në fushën bankare, të sigurimeve dhe konglomeratave financiare.

Disa nga tematikat specifike të trajtuara në seminar lidheshin me zhvillimet më të fundit në procesin dhe metodologjinë e matjes së rrezikut në funksion të mbikëqyrjes dhe aplikimin e tyre në praktikat mbikëqyrëse si:

- Identifikimi i rreziqeve;
- Roli i vetëvlerësimit të riskut dhe aftësisë paguese (ORSA);
- Vlerësimi i brendshëm i mjaftueshmërisë së kapitalit (ICAAP) në procesin e mbikëqyrjes;
- Procesi Rishikues i Mbikëqyrjes (SRP) dhe Procesi Rishikues dhe Vlerësues të Mbikëqyrjes (SREP) në kontekstin ndërkufitar dhe në lidhje me rolin e kolegjeve të mbikëqyrjes;
- Roli i kolegjeve të mbikëqyrjes në inspektimin në vend *(on-site)* dhe përfshirjen e çështjeve ndërsektoriale.

Dita e dytë e seminarit pasoi me një diskutim paneli mbi elementët dhe mënyrat se si mund të kontribuohet më mirë në një kolegj mbikëqyrjeje.

Gjatë seminarit u zhvilluan raste studimore me simulim të zhvillimit të një kolegji mbikëqyrje mbi një konglomerat i cili shtrihej në disa vende të Bashkimit Evropian. Pjesëmarrësit ishin organizuar në grupe me informacione lidhur me problematikat e ndryshme. Gjatë seminarit u diskutuan qëndrimet e ndryshme dhe u votua për zgjidhjet e problematikave të hasura gjatë simulimit.

Raportimi i dytë i shqyrtimit të politikës tregtare për Shqipërinë

Pala shqiptare, përfaqësuese në këtë takim, e vuri theksin ndër të tjera në zhvillimet ekonomike në fusha të ndryshme si shërbimet bankare, jobankare, sidomos përputhjen e legjislacionit me acquis e BE-së, ecurinë që ka pasur vendi ynë në klimën e biznesit.

Në datat 11-13 maj 2016 në Gjenevë, Zvicër, në Organizatën Botërore të Tregtisë, OBT, u zhvillua raportimi i dytë i shqyrtimit të politikës tregtare për Shqipërinë. Raportimi i shqyrtimit të politikës tregtare për çdo vend është një aktivitet shumë i rëndësishëm. Në qendër të këtij raportimi qëndron mekanizmi i rishikimit të politikave tregtare të çdo vendi anëtar në OBT. Për herë të parë ky raportim është bërë në vitin 2010.

Nëpërmjet raportimit zyrtar duhet të dalin në pah marrëdhëniet e vendit përkatës me Organizatën Botërore të Tregtisë, në kuadër të angazhimeve që shteti ka marrë, apo marrëveshjet që shteti ka nënshkruar si për bujqësinë, energjetikën, produktet jo bujqësore, shërbimet, etj.

Pala shqiptare, përfaqësuese në këtë takim, e vuri theksin ndër të tjera në zhvillimet ekonomike në fusha të ndryshme si shërbimet bankare, jobankare, sidomos përputhjen e legjislacionit me acquis të BE-së, ecurinë që ka pasur vendi ynë në klimën e biznesit.

Vlerësimi për Shqipërinë nga sekretariati i OBT-së dhe anëtarët pjesëmarrës të kësaj organizate ishte shumë pozitiv lidhur me zhvillimet ekonomike, sidomos me masat për rimëkëmbjen ekonomike, konsolidimin fiskal, reformën strukturore në energjetikë, lehtësimit të tregtisë, praktikave rajonale dhe më gjerë.

Pyetjet drejtuar pjesëmarrësve në këtë takim, kishin të bënin me reformat ekonomike, strukturore që i shërbejnë sistemit fiskal, masat që parashikohen për lehtësimin e mëtejshëm të tregtisë, qofshin masat

doganore apo legjislative të brendshme, masat që parashikohen në kuadër të *"doing business"* si dhe lidhur me kreditë e këqija. Ulja e këtyre kredive ndikon në rritjen e kreditimit të biznesit.

Shqipëria prezantoi në OBT instrumentet e ratifikimit për marrëveshjen e lehtësimit të shkëmbimeve tregtare duke iu bashkuar 79 vendeve të tjera anëtare të OBT-së. Përfitimet nga kjo marrëveshje janë: procedura doganore të lehtësuara, si dhe shkëmbime të informacioneve doganore për të lehtësuar biznesin.

Forcimi i bashkëpunimit me OBT, aplikimi i standardeve dhe praktikave më të mira për lehtësimin e tregtisë, është synimi i Shqipërisë.

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Shehi përshëndet Konferencën e Dytë Kombëtare për Financën

Znj. Enkeleda Shehi, Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), përshëndeti Konferencën e Dytë Kombëtare për Financën "Sfidat e zhvillimit të ekonomisë shqiptare", të zhvilluar në datën 27 maj 2016. Konferenca u organizua nga Departamenti i Financës i Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës. Në konferencë merrnin pjesë Rektori i Universitetit të Tiranës, përfaqësues nga Banka e Shqipërisë dhe Ministria e Financave, përfaqësues të shoqatës së bankave, të dhomave të tregtisë dhe industrisë, studiues dhe akademikë nga fusha të ndryshme të zhvillimit të ekonomisë, ekspertë të financave dhe përfaqësues të bizneseve të ndryshme në Shqipëri.

Znj. Shehi vuri theksin tek rëndësia e bashkëpunimit që AMF ka pasur ndër vite me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës që prej nënshkrimit të marrëveshjes në vitin 2002. Znj. Shehi theksoi se bashkëpunimi i AMF-së me universitetet është veçanërisht me rëndësi për edukimin e brezit të ri të profesionistëve me njohuritë e nevojshme për sistemet financiare dhe tregjet nën mbikëqyrjen e saj.

Disa nga sesionet kryesore të konferencës trajtonin tematika si:

- Sfondi i zhvillimit të ndërmjetësimit të sistemit të ndërmjetësimit financiar;
- Sipërmarrja e biznesit sipas një trajtimi akademik;
- Ekonomia shqiptare në fokusin e indikatorëve.

Në fjalën e saj përshëndetëse, Znj. Shehi vuri theksin tek rëndësia e bashkëpunimit që AMF ka pasur ndër vite me Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës që prej nënshkrimit të marrëveshjes në vitin 2002. Znj. Shehi theksoi se bashkëpunimi i AMF-së me universitetet është veçanërisht me rëndësi për edukimin e brezit të ri të profesionistëve me njohuritë e nevojshme për sistemet financiare dhe tregjet nën mbikëqyrjen e saj. Si një drejtim tjetër të rëndësishëm bashkëpunimi, Znj. Shehi theksoi edhe fushën e kërkimit shkencor, analizimin e të dhënave, krijimin dhe hartimin e modeleve financiare të cilat ndihmojnë si universitetet edhe AMF-në për të gjeneruar zgjidhje të problematikave me të cilat përballet zhvillimi i tregjeve financiare në vend.

AMF e konsideron të rëndësishëm bashkëpunimin me universitetet edhe në funksion të realizimit të një prej objektivave të saj kryesore, mbrojtjes dhe edukimit të konsumatorit, rritjes së njohurive financiare

dhe ndërgjegjësimin të qytetarëve duke i shërbyer kështu zhvillimit të qëndrueshëm të tregut financiar.

Workshop mbi Inspektimet e Kujdesshme në Vend *(Prudencial on-site Inspection)*

Në datat 25-26 maj, në Ljubljana, Slloveni u zhvillua *workshop-i* mbi Inspektimet e Kujdeshme Onsite brenda SSM *(Single Supervisory Mechanism)* të Bankës Qendrore Evropiane (BQE). Qëllimi i këtij *workshop-i* ishte të sigurojë një platformë për të ndarë eksperiencën në kryerjen e inspektimeve të kujdesshme në vend, për të shkëmbyer mendimet dhe diskutuar sfidat me të cilat përballen rregullatorët në përdorimin e teknikave më të përshtatshme të inspektimit dhe raportimit. Ky *workshop* u organizua nga Qendra e Ekselencës në Financë, e Sllovenisë (CEF) e cila është një iniciativë e Ministrisë së Financave Sllovene. Pjesëmarrësit në *workshop* ishin nga vendet e Ballkanit si Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Mali i Zi, Maqedonia, Republika Serbe e Bosjes, Shqipëria, Turqia. Lektorë në këtë *workshop* ishin ekspertë dhe drejtues nga Banka Kombëtare e Belgjikës.

Gjatë ditëve të workshop-it u prezantua mekanizmi i veçantë mbikëqyrës i emëruar Single Supervision Mechanism-SSM përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe autoritetet kompetente kombëtare të shteteve anëtare pjesëmarrëse. SSM është përgjegjës për mbikëqyrjen e kujdesshme të të gjitha institucioneve të kreditit në shtetet anëtare pjesëmarrëse

Gjatë ditëve të *workshop-it* u prezantua mekanizmi i veçantë mbikëqyrës i emëruar *Single Supervision Mechanism-SSM* përbëhet nga Banka Qendrore Evropiane dhe autoritetet kompetente kombëtare të shteteve anëtare pjesëmarrëse. SSM është përgjegjës për mbikëqyrjen e kujdesshme të të gjitha institucioneve të kreditit në shtetet anëtare pjesëmarrëse. SSM, i cili zyrtarisht ka filluar në nëntor 2014, është në vetvete një hap drejt harmonizimit të madh evropian. Ky promovon qasjen e vetme rregullore për mbikëqyrjen e kujdesshme të institucioneve të kreditit në mënyrë që të rrisin fuqinë e sistemit bankar në eurozonë. Themeluar si një përgjigje ndaj mësimeve të nxjerra nga kriza financiare, SSM është i bazuar në parimet dhe standardet të miratuara në mënyrë të përbashkët. Mbikëqyrja kryhet nga BQE së bashku me autoritetet kombëtare mbikëqyrëse të shteteve anëtare pjesëmarrëse. SSM ka për qëllim të zhvillojë praktikat më të mira të mbikëqyrjes.

Modeli mbikëqyrës SSM përdor një qasje të bazuar në rrezik që synon të vlerësojë rreziqet materiale dhe proceset e menaxhimit të rrezikut në një institucion krediti. Kjo nënkupton një program të plotë të analizës së vazhdueshme të rreziqeve kryesore në të gjitha institucionet e kreditit me anë të mbikëqyrjes së vazhdueshme dhe të inspektimeve në vend. SSM kryen inspektime në vend, pra hetimet në thellësi të rreziqeve, të kontrollit dhe qeverisjes, me tematikë dhe periudhë kohore të paracaktuar në mjediset e një institucioni krediti. Këto inspektime janë bazuar në rrezik.

Gjatë *workshop-it* u diskutua për nevojën për të pasur unione bankare si edhe për kuadrin ligjor mbi të cilin mbështetet unioni bankar në rastin

e SSM. Në vijim u shtjellua procesi i mbikëqyrjes brenda SSM nën mbikëqyrjen e BQE-së si dhe klasifikimi i institucioneve domethënëse në këtë aspekt. Në prezantime u përshkruan llojet e inspektimeve *on-site,* fushat e inspektimit, teknikat e aplikuara, si edhe format dhe përmbajtja e raporteve të inspektimeve brenda SSM. Gjithashtu u përshkrua në hollësi procesi i kryerjes së këtyre inspektimeve në kuadrin e SSM nga BQE. Prezantimet mbuluan edhe informacionet e prezantuara si:

- Zhvillimi i një kuadri për kryerjen e inspektimeve në vend;
- Planifikimi për inspektimet në vend;
- Zhvillimi i tematikës së duhur për një inspektim në vend;
- Organizimi praktik i inspektimeve në vend;
- Njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për inspektimet në vend;
- Raportimi mbi rezultatet e inspektimit në vend.

Gjatë *workshop-it* u zhvilluan edhe dy raste studimi në dy grupe. Njëri rast studimor shtjellonte fazën përgatitore të një inspektimi *on-site*, ndërsa tjetri përbënte simulimin e fazës komunikuese midis Skuadrës së Mbikëqyrjes Kombëtare *(Joint Supervisory Team)* dhe Koordinatorit të Mbikëqyrjes nga Banka Qendrore Evropiane, për sqarimin e paqartësive dhe shtjellimin e objektivave për një inspektim të përbashkët (JST).

Workshop-i i shërbeu rritjes së njohurive mbi strukturën dhe funksionin e mbikëqyrjes brenda SSM, si edhe dhënies së këndvështrimeve të reja përsa i përket mënyrës, formës dhe zbatimit të një inspektimi në vend.

Workshop-i i shërbeu rritjes së njohurive mbi strukturën dhe funksionin e mbikëqyrjes brenda SSM, si edhe dhënies së këndvështrimeve të reja përsa i përket mënyrës, formës dhe zbatimit të një inspektimi në vend.

IOSCO 2016 – pesë ide për rregullatorët e letrave me vlerë

https://www.workiva.com/blog/iosco-2016-5-key-takeaways-securities-regulators

Konferenca e 41të Vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) u zhvillua në Lima, Peru duke mbledhur së bashku rregullatorët e tregut nga më shumë se 115 juridiksione, të cilët për nga vlera zënë rreth 95% të tregjeve globale të kapitalit. IOSCO është e njohur si organizatë për vendosjen e standardeve globale në tregun e letrave me vlerë. Në konferencën e vitit 2016 ishin pesë pika kryesore që u sollën në vëmendje për rregullatorët e letrave me vlerë.

Qëllimi i këtyre rregullave të reja është mbrojtja e investitorëve, formimi i kapitalit të ristrukturuar për emetuesit e rinj dhe ndihma për të përshpejtuar përshtatjen e tregut.

1. Rregullat e financimit *crowdfunding*

Ndryshe nga vendet e tjera, Shtetet e Bashkuara kanë rolin udhëheqës dhe kanë vendosur standardet e financimit *crowdfunding*. Një shembull tjetër në takimin e IOSCO-s erdhi nga një institucion investimesh në Afrikën e Jugut, i cili përsëriti gjatë Konferencës se ky rajon nuk është i vetëdijshëm për potencialin e financimit *crowdfunding*.

Si prezantuese e panelit “Mënyra të reja për Financimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Sfidat e financimit *crowdfunding*”, Mary Jo White, Kryetare e Komisionit të Letrave me Vlerë dhe Këmbimeve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, deklaroi se SEC ka nxjerrë rregulla të reja për financimin *crowdfunding* të letrave me vlerë, të cilat hyjnë në fuqi në datën 16 maj 2016. Qëllimi i këtyre rregullave të reja është mbrojtja e investitorëve, formimi i kapitalit të ristrukturuar për emetuesit e rinj dhe ndihma për të përshpejtuar përshtatjen e tregut.

Kërkesat e reja për financimin *crowdfunding* sipas Aktit JOBS, titulli III përfshijnë:

- Ndërmjetësit e regjistruar në SEC të agjentëve-brokerave;
- Portalet e financimit *crowdfunding* të regjistruara në SEC, për të shërbyer si portierë *(gatekeeper)* për të mbrojtur investitorët;
- Kufizimin e mbledhjes së kapitalit nëpërmjet financimit *crowdfunding* deri në 1 milion dollarë përgjatë një periudhe 12 mujore për çdo emetues;
- Kritere specifike si për periudhën fillestare ashtu edhe për në vazhdimësi për publikimet lidhur me biznesin, ofrimin e letrave me vlerë dhe për pasqyrat financiare.

2. Raportimi i transparencës së firmave audituese

IOSCO pranon që reputacioni i një firme audituese është një faktor i rëndësishëm që investitorët e konsiderojnë në procesin e tyre të vendimmarrjes. Në përpjekje për të përmirësuar cilësinë e auditimit, Bordi i IOSCO-s miratoi në vitin 2016, gjatë Konferencës në Lima publikimin "Raporti i Studimit mbi Mbikëqyrjen e Komitetit të Auditimit për Audituesit". Në këtë publikim, IOSCO deklaron se e pranon që raportimi i transparencës së firmave audituese është një praktikë e drejtë, e cila vazhdon të zhvillohet.

Sipas IOSCO-s, transparenca në raportimin e firmave të auditimit mund të ndihmojë për një analizë të brendshme dhe disiplinë brenda firmave dhe mund t'i inkurajojë ato që të fokusohen në cilësinë e auditit - e cila gjithashtu sjell përfitim për investitorët dhe grupet e të tjera të interesit. Raportimi i transparencës së firmave audituese mund të japë informacion të vlefshëm në lidhje me cilësinë e auditimit për ata që janë përgjegjës për përzgjedhjen e audituesit të një kompanie publike.

IOSCO ka organizuar tryeza diskutimi nëse firmat e auditimit duhet t'i japin më shumë informacion publikut për strukturat e tyre të qeverisjes dhe për operacionet e brendshme, duke përfshirë sistemet e kontrollit të cilësisë, dhe nëse këto raportime mund të kontribuojnë në disa mënyra për përmirësimin e cilësisë së auditimit.

IOSCO ka organizuar tryeza diskutimi nëse firmat e auditimit duhet t'i japin më shumë informacion publikut për strukturat e tyre të qeverisjes dhe për operacionet e brendshme, duke përfshirë sistemet e kontrollit të cilësisë, dhe nëse këto raportime mund të kontribuojnë në disa mënyra për përmirësimin e cilësisë së auditimit. Gjatë vitit 2016, IOSCO do të zhvillojë më shumë diskutime lidhur me këtë temë.

3. Referenca ndërkombëtare për bashkëpunimin ndërkufitar midis rregullatorëve të letrave me vlerë

Bordi IOSCO-s po planifikon mundësinë e zgjerimit të Memorandumit Shumëpalësh të Mirëkuptimit (MMoU) ndërmjet anëtarëve të IOSCO-s, të cilët do të mbështesin kapacitetet e zbatueshmërisë të rregullatorëve në nivel global. Memorandumi i hartuar që në vitin 2002, u ka dhënë rregullatorëve të letrave me vlerë mjetet për të luftuar mashtrimin ndërkufitar dhe keqpërdorimin që mund të dobësojë tregjet globale dhe të ulë besimin e investitorëve.

Komiteti i Presidentëve të IOSCO-s ka miratuar tekstin e një MMoU të re të përmirësuar për bashkëpunimin dhe për shkëmbimin e informacionit. MMoU e përmirësuar, siguron fuqitë shtesë që IOSCO beson se janë të nevojshme për anëtarët e saj rregullatorë, për të siguruar efektivitetin e tyre të vazhdueshëm në frenimin të keqpërdorimit ndërkufitar dhe të mashtrimit në tregjet e letrave me vlerë.

MMoU e re është mbështetur mbi suksesin e MMoU ekzistuese, mbi bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit, e cila është hartuar që 14 vjet më parë. Por MMoU e re merr në konsideratë zhvillimet e reja teknologjike. MMoU e përmirësuar përcakton pesë kompetenca të reja si shtesë përveç atyre që janë në MMoU ekzistuese:

- Të marrë dhe të shkëmbejë dokumente të auditimit;
- Të detyrojë pjesëmarrjen për dëshmi, duke arritur të zbatojë një sanksion në rast të mospërputhshmërisë;
- Të këshillojë dhe të japë informacionin ekzistues tek një tjetër rregullator, për mënyrën se si mund të ngrijë asetet ose të ngrijë asetet në emër të një rregullatori tjetër;
- Të marrë regjistrimet ekzistuese nga ofruesit e Internetit, pa përfshirë përmbajtjen e këtyre komunikimeve;
- Të marrë regjistrimet ekzistuese të telefonatave, pa përfshirë përmbajtjen e këtyre komunikimeve.

4. Qeverisja e Korporatave

Në fushën e qeverisjes korporative, Bordi i IOSCO-s bëri përditësimin lidhur me raportimin e ardhshëm për mënyrën sesi rregullatorët e tregut të kapitalit mund të zbatojnë parimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në qeverisjen korporative për të siguruar tregje më të qëndrueshëm të kapitalit. Raporti pritet që të publikohet në vitin 2016 dhe do të prekë të gjitha vendet anëtare të IOSCO-s.

Në fushën e qeverisjes korporative, Bordi i IOSCO-s bëri përditësimin lidhur me raportimin e ardhshëm për mënyrën sesi rregullatorët e tregut të kapitalit mund të zbatojnë parimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) në qeverisjen korporative për të siguruar tregje më të qëndrueshëm të kapitalit.

5. Përditësime të tjera të politikave të Bordit të IOSCO-s

Bordi i IOSCO-s diskutoi çështjen e likuiditetit në tregjet e obligacioneve të korporatave. Shumë shpejt, Bordi do të publikojë një dokument konsulence për likuiditetin e tregut të obligacioneve të korporatave. Bordi gjithashtu ka miratuar ndërmarrjen e studimeve të mëtejshme për transparencën e tregut të obligacioneve të korporatave në vitet e ardhshme.

Për çështjen e financimit të infrastrukturës, bordi miratoi krijimin e një grupi pune të përbërë nga anëtarë të bordit, të cilët do të angazhohen me bankat e zhvillimit, investitorët institucionalë dhe më grupet e tjera të interesit, për të diskutuar çështje në lidhje me zhvillimin e infrastrukturës. Bordi diskutoi gjithashtu punën e tij lidhur me elasticitetin kibernetik *(cyber resilience)* dhe për FinTech (Teknologjinë Financiare). Ai miratoi mundësinë për përdorimin e mekanizmave të ndryshëm, që rregullatorët e letrave me vlerë të shpërndajnë dhe të marrin informacione për risqet kibernetike dhe për çështjet e sigurisë kibernetike.

Greqi

www.xprimm.com

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka blerë 15% të aksioneve në firmën greke të sigurimeve "*European Reliance*". Aksionet e blera janë mbajtur më parë nga Banka e Pireut, e cila i shiti ato si pjesë e planeve të bankës për të hequr aksionet nga pasuritë jo kryesore.

Kosovë

www.xprimm.com

Sipas të dhënave statistikore të tregut të publikuara nga Banka Qendrore e Kosovës, BQK, në fund të tremujorit të parë të vitit 2016, tregu i sigurimeve në Kosovë arriti në 18.50 milionë euro ose 2.56% më shumë në terma vjetore. Gjatë kësaj periudhe, dëmet e paguara nga siguruesit kosovarë arritën në 8.20 milionë euro, duke shënuar një rënie me 8.71%.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2016, siguruesit e Kosovës kanë lëshuar një total prej 173,930,000 polica sigurimi, nga të cilat vetëm 79, 360 ishin polica sigurimi të brendshme MTPL dhe 40, 670 ishin polica kufitare.

Ukrainë

www.xprimm.com

Byroja e Sigurimeve Motorike (Transportit) të Ukrainës (MTIBU), që nga data 5 maj 2016 ka prezantuar tarifat e reja për policat Green Card, për udhëtimet jashtë shtetit me makinë. Çmimi i Green Card ka rënë me 3.3%.

Që nga viti 2009, janë vënë në zbatim policat Green Card në dy forma: për të gjithë Evropën dhe për Bjellorusinë, Moldavinë dhe Rusinë. Gjithashtu, që nga 1 janari 2016, policat e sigurimeve të Ukrainës Green Card kanë filluar të operojnë edhe në Azerbajxhan.

Në përputhje me MTIBU-në, kostoja e policës Green Card në Ukrainë për 15 ditë udhëtim në Evropë për makinat e udhëtarëve ka rënë në 698 UAH (rreth 24.9 euro) nga 722 UAH (rreth 25.7 euro) që ishte më parë.

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

www.xprimm.com

Në vitin 2015, ekonomitë e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore patën një rritje mesatare rajonale të primeve të shkruara bruto mbi 3%, e mbështetur nga një kërkesë e qëndrueshme vendase. Një pjesë e këtij rigjallërimi ekonomik u përkthye gjithashtu në një tendencë rigjallërimi të biznesit të sigurimeve në rajon, megjithëse ende jo shumë e fortë. Modelet e rritjes ekonomike janë mjaft të ndryshme midis këtyre vendeve dhe po kështu është edhe efekti i tyre për të rritur fuqinë blerëse të popullsisë dhe të bizneseve lokale. Për rrjedhojë edhe mundësitë e rritjes së tregut të sigurimeve kanë qenë jo të njëjta në të gjithë rajonin. Megjithatë, me disa përjashtime, tregjet e sigurimeve të vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore kanë pasur rezultate pozitive.

Shifrat për këto vende për vitin 2015 tregojnë një rritje të primeve të shkruara bruto afërsisht 1.5% të shprehur në monedhë evropiane. Edhe panorama rajonale nuk ndryshon shumë. Polonia mbetet lojtari kryesor në rajon. Më pas renditet Republika Çeke me rritje prej 17.59% dhe Hungaria me rritje 8.43%. Më pas renditet Republika Sllovake, Sllovenia dhe Rumania me përqindje krejtësisht të ngjashme të tregut, prej 6.1-6.26%. Lista e 10 vendeve me rritje më të lartë plotësohet nga Kroacia dhe Bullgaria, Serbia dhe Lituania. Duhet të theksohet se renditja e sigurimeve nuk pasqyron gjithmonë përmasat e vendeve në terma makroekonomike dhe të popullsisë, duke qenë më shumë e ndikuar nga treguesi i të ardhurave mesatare për frymë. Kjo ndikon më shumë përsa i takon sigurimit të Jetës.

Shifrat për këto vende për vitin 2015 tregojnë një rritje të primeve të shkruara bruto afërsisht 1.5% të shprehur në monedhë evropiane. Edhe panorama rajonale nuk ndryshon shumë.

Sigurimi i Jetës zë afërsisht 41% të bizneseve të sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Ndërsa në tregjet më pak të zhvilluara të vendeve jashtë BE-së, ky sigurim llogaritet afërsisht 20% ose edhe më pak të totalit të primeve të shkruara bruto. Në Bullgari dhe Rumani, të cilat janë vendet e BE-së me pasurinë financiare neto më të vogël për familje, vetëm 20% e tregut të sigurimeve përbëhet nga sigurimi i Jetës.

Sigurimi i mjeteve motorike është segmenti i dytë më i madh në industrinë e sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Në tërësi, klasat e sigurimeve të mjeteve motorike llogaritet të zënë rreth 30% të totalit të primeve të shkruara bruto. Megjithatë, viti 2015 ishte një vit mjaft i mirë për sigurimin e mjeteve motorike. Rritja e shitjeve të makinave në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, pavarësisht se është ende larg nga volumet e para krizës, ka pasur një rritje me shitje prej mbi 1.1 milion makina të reja pasagjerësh dhe automjetesh të lehta. Megjithatë, shumë nga vendet e rajonit po përballen me një proces të vazhdueshëm

të plakjes së flotave të tyre kombëtare, gjë e cila e vë theksin më tepër në bilancin financiar të segmentit edhe në karakterin konkurrues të tregut. Është e dukshme rritja e primeve të shkruara bruto në sigurimin Kasko për mjetet motorike në shumë vende, megjithëse shpesh kjo është shoqëruar nga një rritje edhe të pagesave të dëmeve.

Për sa i përket sigurimit MTPL, rritjet kanë qenë si rezultat i rritjes së shitjeve të makinave, si edhe nga efektet e rritjes së tarifave në disa nga vendet e rajonit. Hungaria është i vetmi treg i madh i vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, i cili vitin e kaluar ka pasur një rritje të primeve të shkruara bruto për sigurimet motorike me një ritëm dy shifror, prej pothuajse 14%. Bullgaria dhe Rumania janë gjithashtu me vlerë të përmenden, për normat e rritjes së primeve të shkruara bruto për sigurimin e mjeteve motorike me afërsisht 10%.

Sigurimi i pronës ka funksionuar mirë në shumicën e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore megjithëse në pjesën më të madhe të tyre, ai lidhet më së shumti me risqet nga katastrofat natyrore. Polonia ka nivel të lartë të sigurimit të shtëpive prej 80%, ndërkohë që Hungaria dhe Republika Çeke kanë gjithashtu një mbulim prej mbi 50% të shtëpive me sigurim. Po ky tregues në Rumani arrin në 18%, pavarësisht nga zbatimi i detyrueshëm i skemës së sigurimit për katastrofat natyrore. Në tërësi, pas një viti relativisht të qetë në terma të dukurive ekstreme të motit, linja e sigurimeve të pronës duket se është një nga më fitimprurëset në rajon.

Vendet CIS

www.xprimm.com

Ashtu si shumica e vendeve CIS, Bjellorusia ka qenë e ekspozuar ndaj goditjeve makroekonomike të shkaktuara nga thellimi i krizës, rënia e çmimit të naftës, varësia e saj nga ekonomia ruse dhe nga kursi i këmbimit të Rublës Ruse.

Sipas shifrave paraprake të përpunuara nga xprimm, nëntë nga dymbëdhjetë tregjet e sigurimeve të ish Republikave të Bashkimit Sovjetik (*Commonwealth of Independent States, CIS*) e mbyllën vitin 2015 me "të kuqe". Grupi i tre "performuesve" më të mirë ishin siguruesit Armenë me rritje 13.92% në krahasim me vitin e kaluar, Gjeorgjia me rritje 2.93% dhe Uzbekistani me 21.60% rritje.

Disa tregues të tjerë për tregjet e vendeve të CIS, në fund të vitit 2015, tregojnë se:

- Sipas *ArmInfo News Agency*, duke përfituar nga rezultatet pozitive të regjistruara në sigurimet vullnetare, tregu armen i sigurimeve në vitin 2015 ka njohur një rritje të primeve të shkruara bruto prej 4.3% në krahasim me vitin e kaluar.
- Në vitin 2015, primet e shkruara bruto për siguruesit azerë u rritën me 3.2% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. Megjithatë, për shkak të zhvlerësimit të fuqishëm me pothuajse 80% të monedhës vendase (AZN) kundrejt USD/EUR, tregu ka rënë me 42.35%, i shprehur në monedhën Evropiane, duke arritur në 259.83 milionë euro.

- Ashtu si shumica e vendeve CIS, Bjellorusia ka qenë e ekspozuar ndaj goditjeve makroekonomike të shkaktuara nga thellimi i krizës, rënia e çmimit të naftës, varësia e saj nga ekonomia ruse dhe nga kursi i këmbimit të Rublës Ruse. Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve të Bjellorusisë u rritën me 12% në krahasim me vitin e kaluar. E shprehur në monedhën evropiane, për shkak të zhvlerësimit të monedhës vendase, shifrat e tregut tregojnë një tendencë krejtësisht të ndryshme të primeve të shkruara bruto duke arritur në 400 milionë euro ose 20.66% më pak në krahasim me vitin e kaluar.
- Primet e shkruara bruto për siguruesit gjeorgjianë u rritën me 19% në krahasim me vitin e kaluar, duke arritur në 360 milionë GEL (rreth 137.5 milionë euro). Deri në muajin dhjetor të vitit 2015, në tregun gjeorgjian operonin 14 kompani.
- Pavarësisht përkeqësimit të situatës ekonomike në Kazakistan, në vitin 2015 siguruesit vendas arritën të kishin rritje të primeve të shkruara bruto, ndryshe nga vitet e kaluara.
- Në fund të muajit dhjetor të vitit 2015, tregu i sigurimeve në Moldavi arriti një total prej 1.2 miliardë MDL (rreth 58.8 milionë Euro), ose 2.1% më shumë në krahasim me vitin e kaluar. E shprehur në euro, përqindja në krahasim me vitin e kaluar ka qenë negative, në rënie me -9%. Dëmet e paguara nga 15 siguruesit të cilët kanë operuar në treg kanë arritur në 386.6 milionë MDL ose ekuivalente e 31% të totalit të primeve të shkruara bruto.
- Në vitin 2015, primet e shkruara bruto të siguruesve rusë u rritën me 3.65% në krahasim me vitin e kaluar, duke treguar ritmin më të ngadalshëm të rritjes që nga viti 2009. Ky ritëm në terma reale përkthehet në një ndryshim negativ në krahasim me vitin e kaluar. Rritja e primeve ka qenë e mundur vetëm për shkak të rritjes së tarifës MTPL. Në monedhën evropiane, tregu rus i sigurimeve është ulur me më shumë se 11% duke arritur në 12 miliardë euro.

EIOPA organizon stres-testin mbarë-evropian të sigurimeve për vitin 2016

https://eiopa.europa.eu/Pages/News/EIOPA-reports-on-the-achievements-of-the-supervisory-colleges-.aspx

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) – organizoi stres-testin mbarë evropian për sektorin e sigurimeve.

Për të reaguar sa më mirë ndaj mjedisit aktual sfidues makroekonomik, duke marrë masa të cilat mund të përmirësojnë aftësinë ripërtëritëse të siguruesve evropianë ndaj skenarëve negativë, Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA) – organizoi *stres-testin* mbarë evropian për sektorin e sigurimeve.

Ky ushtrim i rregullt synon që të realizojë vlerësimin e dobësive të siguruesve dhe nuk duhet të interpretohet si një test për të kaluar ose jo. Ai është hartuar për të vlerësuar aftësinë ripërtëritëse të sektorit të siguruesve evropianë ndaj zhvillimeve negative të tregut, duke u bazuar

në kuadrin e përgjithshëm analitik. Për më tepër, ky *stres-test* do të ekzaminojë rritjen e mundshme të rreziqeve sistemike në situata të veçanta.

Stres-testi i vitit 2016 fokusohet në dy risqe kryesore të tregut:

- Mjedisi ekonomik me një normë të ulët e cila është e tillë për një kohë të gjatë;
- E ashtuquajtura "goditje e dyfishtë", d.m.th. një goditje negative e tregut për çmimet e aseteve e kombinuar me një normë të ulët të pasurive pa risk.

Ky *stres-test* është fokusuar vetëm në siguruesit individualë dhe jo në grupet e sigurimit. Synimi ka qenë që të përfshihet një numër sa më i madh i siguruesve të vegjël dhe të mesëm.

Ky stres-test është fokusuar vetëm në siguruesit individualë dhe jo në grupet e sigurimit. Synimi ka qenë që të përfshihet një numër sa më i madh i siguruesve të vegjël dhe të mesëm.

EIOPA po e shfrytëzon këtë ushtrim për të grumbulluar në të njëjtën kohë informacion edhe për *Solvency II* dhe për masat e Garancive Afatgjata *(Long Term Guarantees LTG).*

Data e organizimit dhe fillimit të këtij *stres-testi* ishte 24 maj 2016, e cila është një javë më përpara nga sa ishte planifikuar fillimisht (më 31 maj 2016), për të lejuar kompanitë pjesëmarrëse të sigurimeve që të kenë më shumë kohë për të përfunduar testin.

amf ALBANIA

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. “Dora D’Istria”, Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al